



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
29-06-2021			
Pikimi - Përkujtimshkrimi			
Nr. i Organi	Nr. i Urdhrit	Urdhri	Vlera
Org. broj	Urdh. broj	Delog	Udhadnost
01-110/05-470			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

RREGULLORE

për ndryshimin/plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-110/05-183, të datës: 31.03.2021

Qershor, 2021
VITI

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, shkronja c të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ – MAPL Nr.02/2019, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 36.2, shkronja c të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, me kërkesën e MAPL-së, të datës 16.04.2021, me numër të protokollit 0-295/1, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2021, nxjerr këtë:

RREGULLORE

për ndryshimin/plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-110/05-183, të datës: 31.03.2021

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vitisë, me Nr. 01-110/05-183, të datës 31.03.2021, me rekomandimin e MAPL-së.

Neni 2

Të rregullorja bazë, neni 3, pika 2, ku thuhet: “Komuna e Vitisë themelon 36 këshilla lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe do të paraqiten në listë të veçantë”, shtojca nr. 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Kjo duhet të ndryshohet, pasi që është në kundërshtim me neni 4 të Udhëzimit Nr. 02/2019 për organizim funksionimi dhe bashkëpunimi e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, ku duhet të **përmirësohet dhe të thuhet**: “Komuna e Vitisë nuk mund të ketë më shumë se njëzet (20) këshilla lokale.

Neni 3

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

Neni 4

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen, dhe fillon së zbatuari pas përfundimit të mandatit të këshillave ekzistuese.

Viti, më 29.06.2021

KUVENDI I KOMUNES SË VITISË

